



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-27006 dt. 10-06 2022

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Milaim Hajdari, me dt. **17.06.2022** (e Premte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20. 05.2022.
2. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme bugetore 2023-2025.
3. Propozim Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i autobusëve" SHA në Drenas-Glllogoc.
4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën, 2022-2030.
5. Të ndryshme.

Drenas, 10.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400101.23572 dt. 26.05 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.05.2022, ora 10:00.
Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.04.2022.
2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"
3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas .
4. Qarkorja buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirqenjes Sociale.
6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
7. Raport lidhur me mbarvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë në Komunën e Drenasit.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe katër pika shtesë për rend dite: kemi edhe katër pika shtesë:

1.Njoftim për qarkoren buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.

2. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirqenjes Sociale.

3. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

4. Raport lidhur me mbarëvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë në Komunën e Drenasit.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera për rendin e ditës kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me pikat që u ceken me lartë dhe votuan me: 06 vota (për), abstenim 01, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.03.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"**

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente, Lumnije Krapi- sa i përket kësaj pike, në bazë të ligjit për ndërmarrje publike neni 5 pika 5.2 ku një komonë është aksionare e një ndërmarrje publike lokale të drejtën e saj të aksionarit të ushtroj një komision komunal i aksionareve i cili përbehet nga tre anëtar të emëruar një nga kryetari i komunës dhe dy anëtar tjerë të emëruar nga Kuvendi komunal, gjitha objektivat dhe detyrat tjera sa i përket aksionareve i keni në propozim vendim.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas.**

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente, Lumnije Krapi- duke u bazuar në ligjin për ndërmarrje publike, shoqërinë aksionare. Rregulloren lidhur me kriteret e ndërmarrjes publike kem të drejtën si komunë me formu ndërmarrjen publike që do të funksionon në kuadër të komunës tonë, e keni projekt propozimin, për me u formu në ndërmarrje publike duhet me kalu nëpër disa hapa, ky është hapi parë tani vazhdojmë me hapa tjerë.

Florentina Elezi-Veliu, sa i përket kësaj pike është shumë propozim vendim i mirë, por është shumë i mangët, kush ka me e menaxhu këtë, edhe procedurat tjera, për Komitet për Politike dhe Financa do të abstenoj, ndërsa për kuvend kërkoj material shtesë, sepse për momentin është shumë i mangët.

Arbër Halilaj- ndërmarrja publike lokale jo veten si është çështje e jona si GREEN për Drenas e shohim si zgjidhjen e vetme në raport me keq menaxhimin që ka qenë nga ana e

ndërmarrjen rajonale, është pikë e qëlluar që të kalohet në themelimin e saj mendoj se duhet me analizu vetëm fushë veprimtarinë e saj me çka merret dhe këna me dhënë kontribut.

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente, Lumnije Krapë- themelimi i ndërmarrjes publike ka me kalu edhe me procedura tjera me hapa te tjerë çka parashihet me ligjin për ndërmarrje publike në shoqërinë aksionare, hapi parë është propozim vendimi për themelimin, formohet grupi punues, kuvendin tjetër vjen propozim vendimi për themelimin e grupit punues.

Pas diskutimeve, vërejtje dhe sugjerime që u dhanë kryesuesi e hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Qarkorja buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.**

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- qëllimi i kësaj qarkore buxhetore është të njoftoj mbajtësit e buxheteve komunale rreth informatave që kërkohen dhe orarit kohor për kompletimin e procesit të planifikimit të prioritetëve nga drejtoratet – zyrat komunale për periudhën 2023-2025. Në kuadër të qeverisjes, buxheti përfshin një plan të përgjithshëm për arritjen e synimeve dhe objektivave sipas drejtorive-zyrave komunale. Në pika të shkurtra sqaroj qarkoren buxhetore të cilën është në propozim vendim.

Meqë nuk pati diskutime, u rekomandua edhe kjo pikë e rendit të ditës për kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.**

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale ka paraqit një kërkesë me të cilën parashihet që të përmirësohet furnizimi me pajisje teknologjisë se avancuar mjekësore meqë ishte në pajtim edhe këshilli profesional i QKMF-së dhe me këtë kërkesë ju kane drejtuar Kuvendit Komunal për blerjen e dy autoambulancave të përcillen me këtë kod ekonomik të teknologjisë së avancuar mjekësore me shumë prej 140.000.00 € Kodi 89107 me vlerë prej 140.000.00 € të alukohen me pajisje speciale mjekësore mbi 1.000 € kodi 49181 në vlerë të njëjtë vetëm është ndërrimi i kodit në drejtorinë përkatëse.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, numri i autoambulancave për momentin është 6 të cilat janë në gjendje të mirë që edhe këtë vit kanë kapacitete të mjaftueshme, për vitin e ardhshëm gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm ka qenë kërkesa e këshillit profesional siç e ceki drejtori me lartë dhe ne e kemi përkrah kërkesën e këshillit profesional, dhe si projekt të përfundon brenda një viti.

Florentina Elezi, kërkoj që në propozim vendim të ceket edhe arsyetimi që e ceket me lartë.

Pas diskutimeve, vërejtje dhe sugjerime që u dhanë kryesuesi e hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.**

Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu-kemi një kërkesë për ndërrim të destinimit të tokës të cilën e kemi pranuar me dt. 13.04.2022 bazuar në fletë poseduese toka është e klasës 4 dhe në bazë të udhëzimit administrativ nëni 8 paragrafi 1,2,3,4 dhe 5 të klasa e destinimit prej 1 deri 4 duhet paraprakisht me u dorëzuar kërkesa nga parashtruesi për ndërrimin e destinimit nga toka bujqësore në token ndërtimore duke paraqitur kërkesën te organi i planifikimit, organi i planifikimit e njofton krye shëf in ekzekutiv dhe kryetari i komunës e bënë me propozim vendim për ta proceduar në kuvend. Në nenin 8 paragrafi 8.6 thotë nëse kuvendi komunal e miraton kërkesën për ndërrimin e destinimit brenda 5 ditëve organi i planifikimit në këtë rast komuna duhet me kërku pëlqimin e Ministrisë së pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Arbër Halilaj- ne raste të njëjta si ky propozim vendim jam gjithmonë për, kërkoj për t'ia bashkangjitur një plan të biznesit kësaj kërkesë.

Hamit Haxhiu, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore ne atë ndërtimore a ka ndonjë afat ligjor?

Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu-ndërrimi i destinimit të tokës nëse kalon përmes kuvendit është ndërrim i përhershëm nëse behet ndërrim i përkohshëm në bazë të udhëzimit administrativ behet me pëlqim urbanistik behet deri në 5 vite. Mirëpo pala po kërkon ndërrim të përhershëm dhe kjo shkon përmes kuvendit.

Pas diskutimeve, vërejtje dhe sugjerime që u dhanë kryesuesi e hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raport lidhur me mbarvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë në Komunën e Drenasit.**

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Laureta Thaqi- meqë nuk është obligative dhe nuk është obligim ligjor mirëpo për hir të transparencës e kemi sjellë këtë raport ktu, meqë është një projekt ku po përfitojnë të rinjtë e Drenasit. Raporti i mëposhtëm paraqet në pika të shkurta mbarëvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë" (M4Y) në komunën e Drenasit, marrëveshje kjo e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Elbert Krasniqi, Ministër dhe Komuna e Drenasit, përfaqësuar nga Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës, me datë 30.06.2021.

Si rezultat i performancës më të mirë në nivel të Republikës së Kosovës, Komuna e Drenasit në vitin e kaluar ka përfituar grant për të rinjtë në vlerë prej 250,000.00 dollarë nga MAPL, financuar nga Qeveria e Japonisë në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social dhe administruar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore). Qëllimi i këtij projekti është mbështetja për të rinjtë të zonave rurale, gjysmë urbane dhe urbane. Pra, me fokus të veçantë zonat rurale, grupet e marginalizuara dhe ata me më pak të ardhura. Në takimet të mbajtur me MAPL që është implementuese e projektit dhe përfaqësues të Bankës Botërore. Që nga dhjetori i vitit të kaluar, janë mbajtur takime informuese në vende të ndryshme, si me institucionet lokale, ashtu edhe nëpër bashkësitë lokale. Pra, takime në të dy shkollat e mesme në Drenas, në akademinë "Flutura", me administratorë të fshatrave, në bashkësitë lokale si Fushticë, Krajkovë, Terstenik, Korroticë, Vasilevë, etj. me komunën, me administratorët e fshatrave, me nxënësit nëpër shkolla, HENDIKOS-in në Drenas, grupe rinore, organizata etj. Pra, një gjithëpërfshirës të rinjve, duke inkurajuar gjithashtu edhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të aplikojnë në trajnime dhe grante. Përndryshe, ky është raundi i parë i granteve në kuadër të projektit, pasi deri në fund të vitit do të mbahet edhe një raund sipas marrëveshjes së nënshkruar mes kryetarit Lladrovci dhe ministrit Krasniqi. Sipas

marrëveshjes, MAPL do të financoj 85% të vlerës totale të projektit prej 250,000.00 dollarë përmes alokimeve të saj buxhetore.

Hamit Haxhiu, pyeti për organizata "For New Live Kosovo" prape e ka bërë një kërkesë zyrtare dhe prape nuk e keni mbështet.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Laureta Thaqi- nuk kemi mundësi buxhetore, parashikimi i buxhetit bëhet një vit me herët.

Pasi që nuk pati diskutime tjera edhe këtë pike e rekomanduan për kuvend.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të ndryshme**

Florentina Elez-Veliu, objekti që është i destinuar për gra që për momentin është duke trajtu njerëz për covid çka ka me ndodh pas përfundimit të covidit, besoj ka përfunduar tash veç që nuk ka pacientë, për cilat gra edhe çka ka konkretisht?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – objekti për promovimin e grave është një objekt që e kemi ndertu me organizata ndërkombëtare të huaja, objektin e lëshojmë ne, ne shfrytëzim në baze të vlerësimit që i bënë Kryetari i Komunës pas kërkesave, e lëshoj për arsye se janë të obliguar me i kry detyrat dhe përgjegjësit që i ka, është njëra prej OJQ ma kredibile në Kosove po objekti është i Komunës, me qëllim është bërë për promovim e kemi përdor për Covid-19 se nuk kemi pas tjetër ne shërbim të qytetarëve, objekti kur neve të na nevojitet për diçka tjetër ma të rëndësishëm për shërbim të qytetarit e bëjmë për atë qëllim, objekti është i Komunës, pronë e Komunës, përgjegjësi e Komunës

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:30 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria Government
Komuna/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Kuvendi Komunal



Nr. 052/01-25116 dt. 03.06.2022

Datë:	03/06/2022
Për:	Z. Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Znj. Lumnije Krap, Drejtoreshë e DSHPE-së
Nga:	Komisioni për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020 të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Drenas
Lënda:	Raport i punës së komisionit

I nderuar Z. Hajdari,

Komisioni i formuar me vendim nr. 12-020-4123 i dt. 26/01/2022 ka përfunduar punën, duke plotësuar-ndryshuar statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. në Drenas dhe e ka harmonizuar me projekt statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. të draftuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Pjesë e këtij raporti është Statuti i ri i plotësuar-ndryshuar sipas mandatit të dhënë me vendimin nr. 12-020-4123, nenit 2 të këtij vendimi.

Me respekt,

Komisioni në përbërje:

Valmir Bajraktari – anëtar nga Komiteti i Kuvendit

Gani Krasniqi – anëtar nga kuvendi

Mehedin Salihu – anëtar nga kuvendi





Republik e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Glogocit
Opština Glogovac
Municipality of Glogoc

Datë: 09/03/2022

<http://kk.rks-gov.net/glogoc/>

S T A T U T I

I

NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSAVE ” SH.A. DRENAS (GLLOGOC)

DRENAS (GLLOGOC), Mars 2022

Faqe 1

V.B.

Në pajtim me nenin 34, paragrafi 2, lidhur me nenin 128, të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018" e në mbështetje të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/07 maj 2015", Komisioni komunal i Aksionarëve i Komunës së Drenasit (Glllogocit) për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., në Drenas (Glllogoc), në mbledhjen e mbajtur, më datën _____ njëzëri miratoi këtë:

S T A T U T T Ë NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. NË DRENAS (GLLOGOC)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Statut rregullohen parimet themelore si, emërtimi, selia, veprimtaria e **Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Glllogoc)**, statusi juridik, përfaqësimi-prezantimi, strukturat dhe trupat organizative të institucionit publik, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së **Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Glllogoc)** (në tekstin e mëtejme: "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Glllogoc)).
2. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Glllogoc)**, ka statusin e ndërmarrjes publike lokale, e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë të udhëheq dhe t'i përcaktojë kushtet e udhëheqjes dhe shfrytëzimit të pasurisë së saj, të lidhë kontrata, të punësoj dhe të largojë punonjës nga ndërmarrja dhe të angazhohet në aktivitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 2 Baza ligjore dhe emërtimi

1. Në bazë të nenit 23, të Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike lokale, **"Stacioni i Autobusëve" SH.A. nga Drenasi (Glllogoci)**, është paraparë në listën 2, ku janë caktuar ndërmarrjet publike lokale në nivel të Republikës së Kosovës.
2. Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, **"Stacioni i Autobusëve"**, veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Glllogoc).
3. Emërtimi i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2, të këtij neni është: NPL **"Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Glllogoc)**.

Neni 3

Selia Kryesore

1. Selia kryesore e ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Glllogoc), është në Rr. "Ilaz Kodra" pa nr. në Drenas (Glllogoc).
2. Shenja njohëse (emblema) e NPL-së do të dizajnohet nga Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike lokale dhe do të miratohet nga ky Bord i Drejtorëve.
3. Emërtimi i NPL-së duhet të jetë i mbishkruar në objektin kryesor të NPL-së në të cilën kryhet veprimtaria publike dhe atë në gjuhët zyrtare në përdorim në Republikën e Kosovës.
4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së NPL-së, vendosë themeluesi.

Neni 4

Vula dhe emblema

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Glllogoc), ka vulën e vet, të rrumbullakët dhe katrore.
2. Vula e rrumbullakët është me diametër **2.5 cm** dhe ka këtë përmbajtje:

- 2.1 **Rrethi i parë: Komuna Drenasit (Glllogocit);**
- 2.2 **Rrethi i dytë: "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Glllogoc) dhe**
- 2.3 **Në mes të vulës është emblema.**

3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë **6x2.5 cm**, me përmbajtje:

- 3.1 **NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Glllogoc);**
- 3.2 **Njësia organizative, numri dhe data.**

4. Përmbajtja në vulat e **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Glllogoc), duhet të jetë e shkruar në gjuhët zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Glllogoc) si shoqëri aksionare, është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe aktet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
2. Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet, për këtë duhet të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Republikën e Kosovës dhe të kërkohej që kjo të publikohet nga ana e Agjencisë në bazën e të dhënave të saj.

Neni 6

Fushëveprimtaria e ndërmarrjes

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Glllogoc) ka hapësirë për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, garderobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe

operatorëve të transportit, si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorëve stansportues.

2. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** në Drenas (Glllogoc) është e obliguar që të mbajë evidencën për hyrjen dhe daljen e autobusëve të sektorit publik dhe të sektorit privat.

3. Me fuqizimin e rendit të udhëtimit, Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc) është e obliguar të bëjë sistematizimin e rendit të udhëtimeve sipas relacioneve dhe kohën e nisjes së autobusëve nga stacioni.

4. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc) në kushte të barabarta, i'u ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues, të cilët e kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar në Komunën e Drenasit (Glllogocit), sipas tarifës së përcaktuar nga Komuna e Drenasit (Glllogocit), bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.

5. Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

6. Ndërmarrja do të kryej çdo veprim, me qëllim të marrjes së lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë së saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

7. Harton dhe përpilon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrejtin e linjave urbane dhe të ia prezanton Komunës për miratim.

Neni 7 **Themeluesi i NPL**

1. Komuna e Drenasit (Glllogocit) është pronare e ndërmarrjes, me aksione 100% në pronësinë e saj.

2. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc) është trashëgimtare e ndërmarrjes shoqërore **N.P.T.SH. “KosovaTrans” në Drenas (Glllogoc)** dhe themelohet duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.19/2015 dhe dispozitat e Ligjit Nr-04/L-111, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012”, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L -009 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 07 maj 2015”.

3. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), themelohet pas regjistrimit të Statutit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovë, sipas dispozitave të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018”.

Neni 8 **Statuti dhe rregulloret**

1. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), miraton Statutin si aktin më të lartë themelor të saj. Statuti miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Komisioni komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”**, SH.A. në Drenas (Glllogoc) dhe dorëzohet në organin për regjistrim të shoqërive tregtare pranë Agjencionit për regjistrimin e biznesit të Kosovës (ARBK).

2. Komisioni komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”**, SH.A. në Drenas (Glllogoc), në pajtim me këtë statut, dispozitat e ligjeve në fuqi e miraton, e ndryshon dhe e plotëson Kodin e etikës për ndërmarrjen publike lokale.
3. Rregulloret dhe aktet tjera të Ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), hartohen-perpilohen, miratohen, ndryshohen dhe plotësohen nga Bordi i drejtorëve i Ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), në pajtim me dispozita të nenit 130, të Ligjit Nr-06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe të nenit 20, të Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike dhe nenit 34, të Ligjit në fjalë.

Neni 9 **Përgjegjësitë**

1. Komisioni komunal i Aksionarëve, Bordi i drejtorëve dhe stafi i Ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), është përgjegjëse për pasurinë që gëzon ajo, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i këtij themelimi.
2. Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është kontraktues në këtë shoqëri.

Neni 10 **Përgjegjësitë e themeluesve për veprimet para regjistrimit**

Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish-ndërmarrjes para regjistrimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve të tjera, pasi Shoqëria të jetë regjistruar, ajo merr përsipër përgjegjësinë për këto detyrime dhe në raste të tilla, Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), është e vetmja palë përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

Neni 11 **Kapitali**

1. Kapitali themeltar i ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc) si shoqëri është **10,000.00€** (dhjetë mijë euro) dhe është i ndarë në **10,000** (dhjetë mijë) aksione ku secili prej tyre ka vlerë nominale **një (1) €**.
2. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018”, ku përfshihen, shuma fillestare, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve etj.
3. Aksionar i vetëm i ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc) prej **100%** është Komuna e Drenasit (Glllogoc).

Neni 12

Aksionet

1. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), do të ketë listën e aksionërve.
2. Aksionet janë të formës nominale, të thjeshta ose të privileguara, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë dhe të transferueshme lirisht, sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi në Republikën e Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.
3. Vlera nominale e aksionit të thjeshtë të shoqërisë është: **një (1) €**.
4. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit, në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
5. Aksionet e shoqërisë zotërohen në masën **100%** nga Komuna e Drenasit (Glllogocit).

Neni 13

Regjistri i aksionarëve

1. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), themelon dhe mirëmban regjistrin e aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin. Regjistrat e tillë duhet të përmbajnë informatat e kërkuara në bazë të ligjit, si dhe çfarëdo informate tjetër që ndërmarrja e sheh si të nevojshme.
2. Ndërmarrja publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), nuk do t'i ngarkojë me taksë për shërbime të çfarëdo transferi apo dokumenti tjetër në lidhshmëri me/apo, i cili dëmton titullin e ndonjë aksioni.
3. Sekretari i përgjithshëm, mund të regjistrojë transferin e ndonjë aksioni vetëm kur t'i ofrohet dëshmia mbi transferin në pajtueshmëri me Ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
4. Sekretari i përgjithshëm duhet të lejon aksionarët, të tjerët që parashihen me ligj, si dhe agjentët e tyre relevantë të autorizuar, të shikojnë regjistrin e aksionarëve, dhe duhet të i'u ofrojë atyre ekstrakte (fragmente) relevante nga regjistri, sipas kërkesës së tyre.

Neni 14

Komisioni i Aksionarëve

1. Komisioni i aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SH.A. në Drenas (Glllogoc), është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes publike lokale.
2. Vendimet e mbledhjes së aksionarëve janë detyruese për ndërmarrje, Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes, si dhe zyrtarët e ndërmarrjes.
3. Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kuorumi për mbledhje udhëheqësi i mbledhjes, votat e aksionarëve dhe kompetencat e mbledhjes do të rregullohen me akte të veçantë, në pajtim me dispozitat e nenit 130, të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018”.

Neni 15

Shpërndarja e dividendit

1. Bordi i drejtorëve të ndërmarrjes përcakton dividendin.
2. Shpërndarja e saj do të bëhet vetëm me autorizim të aksionarit, në pajtim me nenin 88 lidhur me nenin 150 të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018”.

Neni 16
Funksioni i Bordit të drejtorëve

Kompetencat dhe përgjegjësitë e ndërmarrjes publike lokale “**Stacioni i Autobusëve**” SH.A. në Drenas (Glllogoc) do të ushtrohen nga Bordi i drejtorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, statutin e “**Stacioni i Autobusëve**” SH.A. në Drenas (Glllogoc) dhe nga aktet të cilat vetë i ka miratuar.

Neni 17
Anëtarët e Bordit të drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve përbëhet nga 5 (pesë) drejtorë me të drejtë vote.
2. Mandati i anëtarit të Bordit të drejtorëve, është 3 (tre) vjet, dhe mund të ri-zgjedhet edhe për një mandat tjetër.
3. Bordi i Drejtorëve mund ta zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe Bordi i Drejtorëve mund të shkarkojë dhe zëvendësojë kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash.
4. Kryesuesi kryeson të gjitha mbledhjet e Bordit dhe kuvendet e aksionarëve dhe është përgjegjës për mbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e Bordit. Nëse kryesuesi nuk është i zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose kuvendet e aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash të drejtorëve të pranishëm shërben si kryesues i mbledhjes ose kuvendit në fjalë.
5. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve do të shërbejnë sipas preferencës së aksionarëve dhe mund të hiqen-largohen në çfarëdo kohe me arsyë apo pa arsyë nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve.
6. Përbërja e Bordit të drejtorëve të NPL “**Stacioni i Autobusëve**” SH.A. në Drenas (Glllogoc) duhet të jetë në harmoni me Ligjin për barazi gjinore.
7. Bordi fillestar i drejtorëve, i zgjedhur nga Komisioni komunal i Aksionarëve, në bazë të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018”, Ligjit Nr-04/L-111, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/15, qershor 2012”, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 31/15, qershor 2008”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L-009 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/07 maj 2015” është në këtë përbërje:

1. Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal - - - - - , kryesues i Bordit;
2. Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal - - - - - , drejtor i Bordit;
3. Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal - - - - - , drejtor i Bordit;
4. Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal - - - - - , drejtor i Bordit dhe
5. Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal - - - - - , kryeshef ekzekutiv, anëtar i Bordit;

Neni 18
Bordi i drejtorëve ka këto detyra dhe përgjegjësi si organ kolektiv

1. Të respektojë ligjet, statutin e ndërmarrjes, aktet të tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin;
2. Të përcaktojë, dhe së paku çdo 3 (tre) muaj të rishikojë strategjinë e ndërmarrjes;
3. Të përgatisë dhe të miratojë strategjinë afatmesëm apo afatgjatë, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe brenda afatit relevant kohor, të rishikojë atë kurdo që është e nevojshme, së paku në çdo 3 (tre) muaj të bëjë ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme;

4. Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv, në bazë të planit afatmesëm apo afatgjatë;
5. Të emërojë, largojë apo zëvendësojë Kryeshefin Ekzekutiv, të përcaktojë, me propozim të Komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe të sigurojë që procesi për përzgjedhjen e KE-së do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë shoqërisë disponueshmërinë e talentëve dhe kompetencave adekuate;
6. Të përcaktojë rastet, përkatësisht çështjet dhe transaksionet, të cilat nuk janë në kompetencë të KE-së, përkatësisht ka fuqi të kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuptim të dispozitave të nenit 177, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
7. Të emërojë dhe largojë ZKFTH dhe sekretarin e përgjithshëm, dhe në bazë të propozimit të Komisionit të auditimit, të përcaktojë kompensimin e tyre;
8. Të përcaktojë, me propozim të KE-së, transaksionet financiare, në bazë të të cilave KE-ja nuk do të ketë fuqinë të veprojë (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, dhe do të duhej të kërkojë autorizim paraprak nga KE-ja, apo nga Bordi i drejtorëve;
9. Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë mbi punën e biznesit të ndërmarrjes mbi punën e KE-së, ZKFTH-së dhe sekretarit të përgjithshëm, mbi organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe mbi performancën e ndërmarrjes, dhe të sigurojë se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuara për të lejuar performancën dhe mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit);
10. Të miratojë, në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit financiar të ndërmarrjes;
11. Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohej me ligj;
12. Raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhej të përfshijë vështirësitë, në atë mënyrë që performanca e ndërmarrjes të mund të barazohet me planet afatmesme apo afatgjata dhe të paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mbulimin e humbjeve;
13. Deklaratën për aksionarët që, sipas njohurive më të mira të Bordit të drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdesshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga Auditori i jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para datës së mbledhjes së Komisionit Komunal të Aksionarëve;
14. Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat janë në vendin e duhur;
15. Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat financiarë, mbahehen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe propozim raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet;
16. Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga Auditori i jashtëm;
17. Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet në zbatim gjatë kryerjes së detyrave;
18. Të identifikojë, me kërkesë të KE-së, shenjat adekuate, në mënyrë që të matet rregullisht performanca e ndërmarrjes publike lokale;
19. Të sigurojë se veprimtaria e ndërmarrjes nuk devijon nga qëllimi që parashihet sipas Statutit pa autorizimin e qartë të Komisionit Komunal të Aksionarëve;

20. Bordi i drejtorëve mund të udhëzojë KE-në në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendimmarrës së bashku me zyrtarët e ndërmarrjes, dhe me propozim të KE-së mund, të caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KE-së, ZKFTI-së, sekretarit të përgjithshëm dhe zyrtarit për auditim të brendshëm), duke vendosur detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 19

Mbledhjet

1. Bordi i drejtorëve duhet të mbledhet në vendin e caktuar sipas njoftimit me shkrim për mbledhje, në zyrën e regjistruar të ndërmarrjes apo diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e kryesuesit apo nga dy (2) e më shumë drejtorë;
2. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tre ditë para mbledhjes, në mënyrë elektronike apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë;
3. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me shkrim dhe të dërgohet me dorë, me faks apo email së paku një ditë para mbledhjes;
4. Në mbledhje, kryesuesi i Bordit të drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, duhet të përcaktojë prezencën e kuorumit, të drejtë debatit, të mbajë procesverbalin, dhe të përcaktojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
5. Sekretari i përgjithshëm do t'i asistojë kryesuesit, përveç nëse çështja e konfidencialitetit kërkon që drejtori të veprojë si sekretar i mbledhjes;
6. Mbledhjet e Bordit të drejtorëve janë të rregullta dhe valide, me prezencën e shumicës së drejtorëve dhe votimin e shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje;
7. Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë paraqitur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërim. Në rast barazimi me vota, kryesuesi i Bordit të drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare;
8. Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë të pranishëm, të udhëheq mbledhjen, dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
9. Sekretari i përgjithshëm i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes;
10. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumente që ndërliohen aty (nëse ka);
11. Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kaluar në mbledhjen e Bordit të drejtorëve, që është thirrur dhe mbajtur.
12. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtorë.

Neni 20

Komisioni i auditimit

Komisioni i auditimit formohet dhe ka përgjegjësi dhe të drejta, siç janë të përcaktuara në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Komisioni i auditimit do të verifikoj se biznesi dhe punët e ndërmarrjes kryhen në mënyrë të ligjshme, me përgjegjësi dhe në interesin ekskluziv të aksionarëve, ashtu siç parashihet me këtë statut dhe me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 21

Zyrtarët

1. Zyrtarët e lartë në ndërmarrjen publike lokale **“Stacioni i Autobusëve”** SLLA në Drenas (Glllogoc) janë: kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit, zyrtari i auditimit të brendshëm, sekretari i përgjithshëm/korporativ dhe zyrtarë të tjerë të caktuar nga Bordi i drejtorëve, në pajtim me Statutin e ndërmarrjes dhe aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.
2. Pranueshmëria e zyrtarëve bëhet në pajtim me aktet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni të bazuar në dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjin e punës në fuqi.

Neni 22

Përgjegjësit e Kryeshefi Ekzekutiv

1. Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes (KE) ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me ligjin, statutin dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 177, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
2. Organizimi i ndërmarrjes bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të drejtorëve;
3. Të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit komunal të Aksionarëve, Bordit të drejtorëve, Komisionit të auditimit/zyrtarit të auditimit të brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë të KE-së;
4. Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet të punësoj apo të largoj nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes duke i respektuar aktet normative që dalin nga Ligji i punës;
5. Këshillon dhe merr pjesë në Bordin e drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
6. T’i propozon Bordit të drejtorëve kandidatë të përshtatshëm për emërim si ZKFTH dhe sekretar i përgjithshëm;
7. T’i dorëzon, Bordit të drejtorëve sipas përgjegjësi të tij projekte të dokumenteve që parashikohen sipas nenit 3, pika 4, (i) dhe nenit 3 pika 4 (ii);
8. T’i ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
9. T’i dorëzon, nën përgjegjësinë e tij/saj, Bordit të drejtorëve dokumente, letra dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
10. Bëjë matjen e performancës së ndërmarrjes dhe i ofron Bordit të drejtorëve rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes ndaj klientëve të saj;
11. Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe alokimin e fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjes, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në ndërmarrje;
12. Ofron Komisionit të auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej;
13. Ofron zyrtarit të auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej nga ai/ajo;
14. Kryen detyra dhe punë të tjera të caktuara me ligjet në fuqi.

Neni 23
Përgjegjësit e Zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit

1. Zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit ("ZKFTH") do të menaxhojë, në drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-së, çështjet financiare të ndërmarrjes. Varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për ndërmarrje dhe do të jetë përgjegjës që:

- 1.1. të mirëmbajë llogaritë e ndërmarrjes (kompanisë) të azhuruara (përditësuara) dhe të sakta;
- 1.2. të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- 1.3. të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- 1.4. të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e ndërmarrjes dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- 1.5. të përgatisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim në fund të vitit;
- 1.6. të rishikojë, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;
- 1.7. të koordinojë funksionet tjera të veprimtarisë, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve;
- 1.8. të menaxhojë thesarin e ndërmarrjes;
- 1.9. të vendosë dhe përgatitë buxhetet dhe
- 1.10. të kryejë edhe punë dhe detyra tjera të caktuara nga KE.

2. Nën mbikëqyrjen e Komisionit të auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, zyrtari i auditimit të brendshëm të ndërmarrjes, do të jetë përgjegjës për:

- 2.1. Udhëheqjen dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së auditimit;
- 2.2. Udhëheqjen dhe drejtimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe
- 2.3. Përmblidhjen çfarëdo detyre tjetër, të përcaktuar nga ana e Komisionit të auditimit.

Neni 24
Sekretari i përgjithshëm i ndërmarrjes

Sekretari i përgjithshëm i ndërmarrjes do të jetë përgjegjës për:

1. mirëmbajë regjistrin e askionarëve;
2. vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
3. kryejë të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj ose nga ky statut;
4. mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurimin (përditësimin) e rregullt të ueb-faqes;
5. koordinojë me KE-në përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Bordit të drejtorëve;
6. të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të drejtorëve dhe të Komisionit të auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe do t'i shënojë ato në librat e protokolleve;
7. Procesverbali do të përmbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të veçanta të rendit të ditës, tekstin e vendimeve të propozuara, rezultatit e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës),

tekstin e saktë të vendimeve të arritura si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e miratuara;

8. Procesverbali për mbledhjet e Komisionit komunal të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve, do të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes i Bordit dhe nga sekretari dhe do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhës;

9. Procesverbali i mbledhjes do të jetë në dispozicion të aksionarëve dhe drejtorëve, me kërkesën me shkrim;

10. Procesverbali i secilës mbledhje të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhës të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve;

11. Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të drejtorëve do të nënshkruhet nga ana e kryesuesit të Bordit të drejtorëve dhe do t'u shpërndahet anëtarëve të Bordit të drejtorëve;

12. Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe për procesverbalet e Komisionit të auditimit.

Neni 25

Detyrat e besuara

1. Secili drejtor dhe zyrtar do të kenë detyra për ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë që: të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;

2. të ushtrojnë fuqinë që i'u është dhënë atyre ekskluzivisht, në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;

3. të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlíkueshmërinë e tyre;

4. të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;

5. të shmangë dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkt apo indirekt) dhe të interesave të shoqërisë;

6. të ushtrojnë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre;

7. të trajtojnë si konfidenciale të gjitha informatat e pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 26

Veprimet e Bordit pa mbajtjen e mbledhjes

Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkohet që një aktivitet i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të Bordit:

1. të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e Bordit mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes, nëse pëlqimi me shkrim, që përmban edhe natyrën e aktivitetit përkatës, nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje,

2. të gjitha këto pëlqime duhet të përmbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarrë, si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve,

3. të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin e mbledhjes së Bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

4. pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 27

Komisionet e bordit

1. Bordi i drejtorëve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton, kur mund të miratojnë themelimin e një ose më shumë komisioneve, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve) që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo-obligative, që janë në kuadër të kompetencës së Bordit.
2. Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e Bordit të drejtorëve dhe të punësuarit e shoqërisë, si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcaktimit në rregullore.
3. Miratimi i rregulloreve për marrjen e vendimeve të Bordit kërkon një numër më të madh, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit, me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 28

Transparenca

1. Pas çdo takimi të Bordit të drejtorëve do të lëshoj një raport të shkurtër të hartuar qartë, duke vënë në pah një përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme dhe rekomandimeve të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet sekret i arsyeshëm; informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur sekretin.
2. Bordi i drejtorëve dhe Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj, hartonë një raport të shkurtër, të qartë, që nxjerr në pah të gjitha rastet në të cilat cilido drejtor apo zyrtar ka deklaruar ekzistimin e konfliktit potencial të interesave dhe ka abstenuar – përmbajtur nga votimi ose nga veprimi, duke dhënë indikacione për natyrën e interesave dhe vendimet vepruese për shkak të cilave janë ngritur ato. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet. Informacioni në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të drejtorit apo zyrtarit përkatës.
3. Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj, harton raport të shkurtër e të qartë, duke nxjerr në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura, të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mosmiratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar, duke paraqitur vlerën e transaksioneve; vlerën e bilanceve të papaguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garancionet; provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e pranuar gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të papagueshme) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse të ndërlidhura, si dhe deklarata se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për kompaninë.
4. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahen, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të kompanisë, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme, kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet. Informacioni në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të palës përkatëse të ndërlidhur.
5. Ndërmarrja do të krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të azhurojë, në përgjegjësinë e KE-së dhe sekretarit të përgjithshëm, 1, (një) ueb-faqe, ku do të paraqiten së paku këto informacione:
 - 5.1 Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raporti për dokumentet e tilla nga Komisioni i auditimit;

- 5.2 Raportin nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me NPI;
- 5.3 Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet të fundit. Atëherë kur ndërmarrja të veprojë në një treg garues, ajo mund të fshijë nga shpalosjet e tilla të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet;
- 5.4 Regjistrin e linjave urbane dhe numrin e operatorve
- 5.5 Publikimi i të gjitha akteve Ligjore dhe aktet tjera nën Ligjore që rregullojnë fushëveprimtarin e ndërmarrjes publike lokale;
- 5.6 Listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjellë;
- 5.7 Listën e dhjetë (10) furnizuesve më të rëndësishëm të ndërmarrjes, me çmimet e furnizimeve;
- 5.8 Rendin dhe nisjet e të gjitha relacioneve në të gjithë territorin e Komunës së Drenasit (Glllogocit).
- 5.9 Çfarëdo padie në gjyq apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve ose zyrtarëve, apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të drejtorëve;
- 5.10 Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shpërndahen në paragrafë të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'iu qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të përfshihet në një paragraf të vetëm të ueb – faqes, e cila i dedikohet shpalosjeve publike për çështjet e korporatës dhe do të vendoset në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet lehtë, secila nga këto në një format që mund të printohet lehtë.

Neni 29

Detyrimi për mos konkurrencë

Zyrtarët dhe drejtorët nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes. Kjo konkurrencë përfshinë por nuk kufizohet vetëm në punësimin, të qenit ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.

Neni 30

Miratimi i Statutit, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit

Ndërmarrja mund të miratojë statut të ri nëse ndryshimi i statutit bëhet mbi 50%, të bëjë ndryshimin, plotësimin, apo ta ndryshojë dhe plotësojë atë me qëllim të harmonizimit të tij me dispozitat e ligjit apo akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 31

Likuidimi i ndërmarrjes

Likuidimi i ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar me nenin 210 të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018”.

V.15

Neni 32

Ushtrimi i detyrimeve sipas vendimit personal ose të gjykatës

1. Aksionarët kanë të drejtë të paraqesin padi në gjykatë në emrin e ndërmarrjes kundër një ose më shumë drejtorëve ose zyrtarëve, nëse këta aksionarë kanë arsye bindese për të besuar se zyrtarët dhe drejtorët përkatës kanë shkelur detyrën ndaj ndërmarrjes dhe me këtë e kanë dëmtuar ndërmarrjen.
2. Ankesat e paraqitura në këtë mënyrë duhet të përshkruajnë në hollësi ose (i) përpjekjet që janë bërë nga aksionarët për ta shtyrë Bordin e drejtorëve që ta paraqesë ankesën në emër të ndërmarrjes ose (ii) një deklaratë se këto përpjekje nuk janë ngase do të kishin qenë të padobishme, së bashku me një deklaratë ku paraqiten arsyet për mbështetjen e kësaj deklarate.
3. Nëse aksionarët ankues janë të suksesshëm në këtë rast, të gjitha kompensimet e dhëna dhe të pranuara janë pronë e ndërmarrjes.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË HYRJES NË FUQI

Neni 33

Dispozitat kalimtare

1. Për çfarë nuk është thënë në Statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018", të Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L -009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 07 maj 2015".
2. Harmonizimi i të gjitha rregulloreve të ndërmarrjes publike lokale dhe akteve tjera të ndërmarrjes me këtë Statut, duhet të bëhet në afat prej 3, (tre) muajsh nga dita e miratimit të këtij Statuti.
3. Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Neni 34

Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës

Rregullorja për organizmin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Ndermarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Drenas (Glllogoc), përmban pjesën mbi organizimin e brendshëm dhe organogramin përkatës dhe sistematizimin e zyrtareve të ndërmarrjes së lartcekur.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve, ky Statut hyn në fuqi 8, (tetë) ditë dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Ndermarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Drenas (Glllogoc).

KOMISION I KOMUNAL I AKSIONARËVE

Nr. _____

Me datë _____

1. Kryesuesi _____

2. Anëtar _____

3. Anëtar _____

VËREJTJE: Pjesë e këtij statuti është edhe Organogrami apo struktura organizative e Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A.- në Drenas (Glllogoc).



KOMUNA E DRENSIT
(GLLOGOCIT)

THE MUNICIPALITY OF DRENAS (GLLOGOC)



N.P.L "STACIONI I AUTOBUSËVE"
SH.A. NË DRENAS (GLLOGOC)

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I
AUTOBUSËVE" SH.A. NË DRENAS (GLLOGOC)**

